

## GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË/MITROVICA

P. nr. 22/2010

8 Nëntor 2011

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË**, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Caroline Charpentier, si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Nikolay Entchev dhe Gjyqatri penalist Ali Kutllovci, si anëtarë të trupit gjykues, me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Anu Juho, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër:

**Safet Goxhulit**, emri i babës Ramadan, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Miradije Doka, i lindur më 05.02.1972 në fshatin Makërmal në Skenderaj, me banim në vendbanimin e njëjtë të përhershëm, operator mekanik industrial në KEK, i martuar, tre fëmijë, të kryer shkollën e mesme teknike, të ardhurat mujore 400 Euro në muaj,


**Agron Goxhulit**, emri i babës Hetem, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Raba Olluri, i lindur më 05.07.1979 në fshatin Makërmal në Skenderaj, me banim në vendbanimin e njëjtë të përhershëm, të kryer shkollën e mesme teknike, auto mekanik, i martuar, tre fëmijë, të ardhurat mujore 300 Euro në muaj;

**Ahmet Goxhulit**, emri i babës Adem, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Ziza Mehmeti, i lindur më 01.03.1972 në fshatin Makërmal në Skenderaj, me banim në vendbanimin e njëjtë të përhershëm, të kryer shkollën e mesme teknike, elektrikist, i papunë, i martuar, tre fëmijë;

të akuzuar për dy vepra penale, Vrasje e Rëndë nga Neni 147 Paragrafi (1), Pika 4), dhe Vrasje e Rëndë në Tentativë nga Neni 147, Pika 4) lidhur me Nenin 20 të KPK dhe të gjitha këto të dënueshme sipas pikës 11 të Nenit 147 lidhur me Nenin 23 të KPK

dhe për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve në shkelje të Nenit 328, Paragrafi (2) i Kodit Penal të Kosovës (KPK) në bashkim real me veprat penale të përshkruara më lartë.

**Bashkim Igrishtës**, emri i babës Isa, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Fata Zeqiri, i lindur më 30.11.1977 në Mitrovicë, me banim në Rr. "Ulqini" në Mitrovicë,



shkollën fillore të kryer, vazhdon shkollën profesionale të mekanikut, nuk e ka kryer, i pa punë, i martuar-tre fëmijë, pa të ardhura;

i akuzuar për Vrasje në tentativë në shkelje të Nenit 146 lidhur me Nenin 20 të KPK;

**Xhemë Igrishtës**, emri i babës Isa, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Fata Zeqiri, i lindur më 10.01.1980, në Mitrovicë, me banim në Rr. "Ulqini" në Mitrovicë, Shqiptar i Kosovës, shkollën e mesme të kryer, i pamartuar, pa të ardhura;

i akuzuar për Kanosje në shkelje të Nenit 161 Paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPK;

Pas lëshimit të vendimit mbi ndërrimin e vendit të gjykimit nga Shefi i Komponentës së Drejtësisë së EULEX-it më 11 Tetor 2011;


Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor gjyqësor të hapura për publikun në sallën e gjykimit në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë më 17, 18, 19 Tetor dhe 01, 02, 03 Nëntor 2011 dhe pas vendshiqimit që nuk ishte i hapur për publik më 20 Tetor 2011, në praninë e të Akuzuarëve Safet Goxhuli, Agron Goxhuli, Ahmet Goxhuli, Bashkim Igrishta dhe Xhemë Igrishta (përveç datës 20 Tetor 2011), Avokatëve të tyre Mbrojtës Bajram Kaitazi, Bashkim Mehana, Haxhi Millaku, Agim Lushta, Nexhat Beqiri (përveç datës 20 Tetor 2011), Prokurorit Publik të EULEX-it Adebayo Kareem, Palëve të Dëmtuara (përveç datës 20 Tetor 2011), Jashar Sadikut, i cili ishte i pranishëm vetëm më 17 Tetor 2011 dhe Ramadan Goxhulit, i cili ishte i pranishëm më 18 Tetor 2011 dhe 02 Nëntor 2011;

Pas këshillimit të trupit gjykues dhe votimit të mbajtur më 04 Nëntor 2011, në pajtim me Nenin 392 Paragrafi (1) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), shpalli më 08 Nëntor 2011, publikisht dhe në prani të personave të Akuzuar, Avokatëve të tyre Mbrojtës, Prokurorit Publik të EULEX-it Adebayo Kareem dhe Palës së Dëmtuar Fata Igrishta, këtë:

## **AKTGJYKIM**

**I Xhemë Igrishta**, emri i babës Isa, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Fata Zeqiri, i lindur më 10.01.1980, në Mitrovicë, me banim në Rr. "Ulqini" në Mitrovicë, Shqiptar i Kosovës, shkollën e mesme, i pamartuar, pa të ardhura;

## **SHPALLET I PAFAJSHËM**



- **SEPSE** nuk ka dëshmi që Xhemë Igrishta iu është kanosur Ramadan Goxhulit apo Musa Goxhulit më 03 Dhjetor 2009.

Prandaj, në pajtim me Nenin 390 Pika 3) e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) i Akuzuari Xhemë Igrishta lirohet nga akuza **Kanosje**, në kundërshtim të Nenit 161 Paragrafi 4 lidhur me Paragrafin 2 të KPK (Pika 3 e aktakuzës).

Në pajtim me Nenin 102 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), i Akuzuari lirohet nga detyrimi për kompenzimin e shpenzimeve.

**II Safet Goxhuli**, emri i babës Ramadan, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Miradije Doka, i lindur më 05.02.1972 në fshatin Makërmal në Skenderaj, me banim në vendbanimin e njëjtë të përhershëm, operator mekanik industrial në KEK, i martuar, tre fëmijë, të kryer shkollën e mesme teknike, të ardhurat mujore 400 Euro në muaj;

### **SHPALLET FAJTOR**

**A. - sepse** më 04 Dhjetor 2009 rreth orës 12:30 në udhëkryqin e rrugëve Sylë Vokshi dhe Ulqini në Mitrovicë, me pistoletën e tipit TT, ngjyrë e zezë, me numër serik 967473766-1964, Safet Goxhuli ka shtënë në Isa Igrishtën dhe Makfire Igrishtën, duke i qëlluar ata me plumba me ç'rast ka shkaktuar vdekjen e tyre.


Duke vepruar kështu, i akuzuari Safet Goxhuli ka kryer dhe është përgjegjës për veprimin kriminal

**Vrasje e Rëndë**, në kundërshtim të Nenit 147 § 11 të KPK (Pika 1 e akakuzës).

I Akuzuari Safet Goxhuli

### **SHPALLET I PAFAJSHËM**

**B. - sepse** nuk është vërtetuar se me datën 04 Dhjetor 2009 rreth orës 12:30 në udhëkryqin e rrugëve Sylë Vokshi dhe Ulqini në Mitrovicë, Safet Goxhuli ka tentuar ta vrasë Bashkim Igrishtën duke shtënë në të me pistoletën e tipit TT, ngjyrë e zezë me numër serik 967473766-1964, si bashk-kryerës me Agron Goxhulin dhe Ahmet Goxhulin.



Prandaj, në pajtim me Nenin 390 Pika 3) e KPK, i akuzuari Safet Goxhuli lirohet nga akuza **Vrasje e Rëndë në Tentativë**, në kundërshtim të Nenit 147 Pika 4 lidhur me Nenin 20 të KPK.

I Akuzuari Safet Goxhuli

### **SHPALLET FAJTOR**

**C. –sepse** më 4 Dhjetor 2009 Safet Goxhuli kishte me vete një armë, pistoletë e tipit TT, ngjyrë e zezë me numër serik 967473766-1964 në të cilën kishte fyshekë, pa leje në udhëkryqin e rrugëve Sylë Vokshi dhe Ulqini në Mitrovicë.

Duke vëpruar kështu, i Akuzuari Safet Goxhuli ka kryer dhe është përgjegjës për veprën penale

**Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi 2 i KPK.

PRANDAJ, i Akuzuari Safet Goxhuli


### **DËNOHET**

**A.** Me katërmbëdhjetë (14) vjet burgim për veprimin kriminal **Vrasje e Rëndë**, nga Neni 147 pika 11 e KPK (Pika I e aktakuzës);

**B.** Me (1) vit burgim për veprimin kriminal **Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi 2 i KPK. (Pika II e aktakuzës).

Dënimi unik caktohet në katërmbëdhjetë (14) vjet e gjashtë (6) muaj burgim, në pajtim me Nenin 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) pika 2 e KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 04 Dhjetor 2009 do të llogaritet sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.



Arma – pistoleta e tipit TT, me ngjyrë të zezë me numër serik 967473766-1964 në të cilën kishte fyshekë konfiskohet në pajtim me Nenin 60 Paragrafi (1) dhe Nenin 328 Paragrafi (5) i KPK.

I Akuzuari Safet Goxhuli do t'i kompenzojë 300 Euro për pjesën e tij të shpenzimeve të procedurës penale në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) i KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit gojor dhe me shkrim.

**III Agron Goxhuli**, emri i babës Hetem, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Raba Olluri, i lindur më 05.07.1979 në fshatin Makërmal në Skenderaj, me banim në vendbanimin e njëjtë të përhershëm, të kryer shkollën e mesme teknike, auto mekanik, i martuar, tre fëmijë, ardhurat mujore 300 Euro në muaj;

### **SHPALLET I PAFAJSHËM**

**A. - sepse** nuk është vërtetuar se më 04 Dhjetor 2009 rreth orës 12:30 min në udhëkryqin e rrugëve Sylë Vokshi dhe Ulqini në Mitrovicë, Agron Goxhuli me armën e tij, pistoletë e tipit TT, ngjyrë e bardhë, numri serik 160982, ka shtënë në Isa Igrishtën dhe Makfire Igrishtën dhe duke vepruar ka shkakuar vdekjen e tyre, si bashk-kryerës me Safet Goxhulin dhe Ahmet Goxhulin.


Prandaj, në pajtim me Nenin 390 Pika 3) e KPPK i Akuzuari Agron Goxhuli **lirohet** nga akuza për Vrasje të Rëndë, në kundërshtim të Nenit 147 Paragrafi 1 pika 4.

I Akuzuari Agron Goxhuli

### **SHPALLET I PAFAJSHËM**

**B. - sepse** nuk është vërtetuar se më 04 Dhjetor 2009 rreth orës 12:30 min në udhëkryqin e rrugëve Sylë Vokshi dhe Ulqini në Mitrovicë, Agron Goxhuli ka tentuar ta vrasë Bashkim Igrishtën duke shtënë në të me pistoletën e tipit TT, me ngjyrë të bardhë me numër serik 160982, si bashk-kryerës me Safet Goxhulin dhe Ahmet Goxhulin.

Prandaj, në pajtim me Nenin 390 Pika 3) e KPPK i akuzuari Agron Goxhuli lirohet nga akuza për **Vrasje të Rëndë në Tentativë**, në kundërshtim të Nenit 147 Paragrafi 4 lidhur me Nenin 20 të KPK.



I Akuzuari Agron Goxhuli

### **SHPALLET FAJTOR**

**C. - sepse** më 4 Dhjetor 2009 Agron Goxhuli ka pasur me vete një armë, pistolet e tipit TT, ngjyrë e bardhë, me numër serik 160982, në të cilën kishte fyshekë, pa leje në udhëkryqin e rrugëve Sylë Vokshi dhe Ulqini në Mitrovicë.

Duke vepruar kështu, i Akuzuari Agron Goxhuli ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale

**Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve** në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2) e KPK.

PRANDAJ, i Akuzuari AGRON GOXHULI

### **DËNOHET**


**A.** Me një (1) vit burgim për veprimin kriminal **Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve** në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2) e KPK (Pika II e aktakuzës).

Koha e kaluar në paraburgim nga data 04 Dhjetor 2009 do të llogaritet sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

Arma – pistoletë e tipit TT, ngjyrë e bardhë, numëri serik 160982, në të cilën kishte fyshekë, konfiskohet në pajtim të Nenit 60 Paragrafi (1) dhe Nenit 328 Paragrafi (5) i KPK.

I Akuzuari Agron Goxhuli do t'i kompenzojë 100 Euro për pjesën e tij të shpenzimeve në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) i KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit gojor dhe me shkrim.

IV Ahmet Goxhuli, emri i babës Adem, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Ziza Mehmeti, i lindur më 01.03.1972 në fshatin Makermal në Skenderaj, me banim në vendbanimin e njëjt të përhershëm, të kryer shkollën e mesme teknike, elektrikist, i papunë, i martuar, tre fëmijë



## SHPALLET FAJTOR

**A - sepse** më 04 Dhjetor 2009 rreth orës 12:30 min. në udhëkryqin e rrugëve Sylë Vokshi dhe Ulqini në Mitrovicë, me pistoletën e tipit M57 me numër serik 132205, Ahmet Goxhuli ka shtënë në drejtim të Makfire Igrishtës, duke e qëlluar me një plumb dhe me këtë i ka shkaktuar vdekjen.

Duke vepruar kështu, i Akuzuari Ahmet Goxhuli ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprimin kriminal

**Vrasje**, në kundërshtim të Nenit 146 të KPK.

I Akuzuari Ahmet Goxhuli

## SHPALLET I PAFAJSHËM

**B. - sepse** nuk është vërtetuar se me datën 04 Dhjetor 2009 rreth orës 12:30 min, në udhëkryqin e rrugëve Sylë Vokshi dhe Ulqini në Mitrovicë, Ahmet Goxhuli ka tentuar ta vrasë Bashkim Igrishtën duke shtënë në të me pistoletën e tipit M57 me numër serik 132205, si bashkëkryerës me Safet Goxhulin dhe Agron Goxhulin.

Prandaj, në pajtim me Nenin 390 Pika 3) e KPK i akuzuari Ahmet Goxhuli **lirohet** nga akuza për Vrasje në Tentativë, në kundërshtim të Nenit 146 të KPK lidhur me Nenin 20 të KPK.


I Akuzuari Ahmet Goxhuli

## SHPALLET FAJTOR

**C. – sepse** më 04 Dhjetor Ahmet Goxhuli kishte me veti një armë pa leje, pistoletë e tipit M57 me numër serik 132205, në udhëkryqin e rrugëve Sylë Vokshi dhe Ulqini në Mitrovicë.

Duke vepruar kështu, i Akuzuari Ahmet Goxhuli ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprimin kriminal

**Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armës** në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2) i KPK.



PRANDAJ, i Akuzuari Ahmet Goxhuli

## DËNOHET

**A.** Me katër (4) vjet burgim për veprimin kriminal **Vrasje**, nga Neni 146 i KPK CCK (Pika I e aktakuzës);

**C.** Me një mijë (1.000) Euro gjobë për veprimin kriminal **Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armës** në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2) i KPK (Pika II e aktakuzës).

Dënimi unik caktohet në katër (4) vjet burgim dhe një mijë (1.000) Euro gjobë, në pajtim me Nenin 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) pika 2 e KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 04 Dhjetor 2009 do t'i llogaritet sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.


Arma – pistoletë e tipit M57 me numër serik 132205, konfiskohet në pajtim me Nenin 60 Paragrafi (1) dhe Nenin 328 Paragrafi (5) i KPK.

I Akuzuari Ahmet Goxhuli do ta kompenzojë pjesën e tij të shpenzimeve të procedurës penale në shumën prej 300 Euro në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) i KPPK me përjashtim të përkthimit gojor dhe me shkrim.

**V. Bashkim Igrishta**, emri i babës Isa, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Fata Zeqiri, i lindur më 30.11.1977 në Mitrovicë, me banim në Rr. "Ulqini" në Mitrovicë, shkollën fillore të kryer, vazhdon shkollën profesionale të mekanikut, nuk e ka kryer, i pa punë, i martuar-tre fëmijë, pa të ardhura;

## SHPALLET FAJTOR

**A. – sepse** me datën 04 Dhjetor 2009 në udhëkryqin e rrugëve Sylë Vokshi dhe Ulqini në Mitrovicë, ka shpejtuar veturën e tij, tip BMW, dhe e ka ngarë në drejtim të viktimës Ahmet Goxhulli, me qëllim që ta privojë atë nga jeta, e ka goditur në këmbë dhe e ka dërguar me forcë te muri. Si pasojë, Ahmet Goxhulli ka rënë mbi kapakun e motorit të veturës. Veprimi i tij ka mbetur në tentativë pasi që ai është detyruar të largohet nga vendi i ngjarjes pasi ka dëgjuar të shtënat e armës dhe kur e ka kuptuar se e kishte goditur viktimën.



Duke vepruar kështu, i akuzuari Bashkim Igrishta ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprimin kriminal

**Vrasje në Tentativë** ndaj Ahmet Goxhulit, në kundërshtim të Nenit 146 lidhur me Nenin 20 të KPK.

Prandaj, i Akuzuari Bashkim Igrishta

## DËNOHET

**A.** Me shtatë (7) vjet burgim për Veprimin kriminal Vrasje në tentativë, nga neni 146 lidhur me Nenin 20 të KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 04.12.2009 do t'i llogaritet sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.


Vetura BMW konfiskohet sipas Nenit 54 Paragrafi 2 dhe Nenit 60 Paragrafi (1) i KPK.

I Akuzuari Bashkim Igrishta do ta kompenzojë pjesën e tij të shpenzimeve të procedurës penale në shumën prej 300 Euro në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) i KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit gojor dhe me shkrim.

## ARSYETIM

### A. Rrjedha e Procedurës

Prokurori i Qarkut të Mitrovicës në Aktakuzën PP nr. 405/09 të parashtruar më 26 Maj 2010, ka akuzuar Safet Goxhulin, Agron Goxhulin dhe Ahmet Goxhulin për veprat penale Vrasje e Rëndë, në shkelje të Nenit 147 Paragrafi 1, Pika 4) dhe 11) dhe për Vrasje të Rëndë në Tentativë në shkelje të Nenit 147, Paragrafi 1, Pika 4) dhe 11) lidhur me Nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe i ka akuzuar gjithashtu për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve në shkelje të Nenit 328 Paragrafi (2) i Kodit Penal Të Kosovës në bashkim real me veprat penale të përshkruara më lartë. Bashkim Igrishta është akuzuar për Vrasje në Tentativë në shkelje të Nenit 146 lidhur me Nenin 20 të KPK. Xhemë Igrishta



është akuzuar për Kanosje në shkelje të Nenit 161 Paragrafi (4) lidhur me Paragrafin 2 të KPK.

Aktakuza është konfirmuar më 14 Qershor 2010. Me datën 02 Dhjetor 2010, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ua ka caktuar rastin gjyqtarëve të EULEX-it në bazë të Nenit 3.3 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it.

Seancat dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur më 17, 18, 19 Tetor dhe më 01, 02, 03 Nëntor 2011 në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë dhe vendshiqimi është bërë më 20 Tetor 2011. Fjalët përfundimtare nga Prokurori Publik i EULEX-it Adebayo Kareem dhe nga Avokatët Mbrojtës janë dëgjuar më 03 Nëntor 2011.

Aktgjykimi është shpallur gojarisht më 08 Nëntor 2011.

## **B. Kompetenca e Gjykatës**

Sipas Nenit 23 Pika 1 i) e KPPK, gjykatat e qarkut janë kompetente për t'i dëgjuar rastet që përfshijnë akuzat për të cilat ligji lejon shqiptimin e dënimit penal prej së pakut pesë vjetë. Sipas Nenit 27 Paragrafi (1) i KPPK, kompetenca territoriale i jipet gjykatës në territorin e së cilës pretendohet se është kryer vepra penale.

Personat e akuzuar akuzohen si në vijim:

- Safet Goxhuli, Agron Goxhuli dhe Ahmet Goxhuli për veprat penale Vrasje e Rëndë, në shkelje të Nenit 147 Paragrafi (1), Pika 4) dhe Pika 11) që mundëson shqiptimin e dënimit penal prej së pakut dhjetë vjet burgim, për Vrasje të Rëndë në Tentativë në shkelje të Nenit 147, Paragrafi (1), Pika 4) dhe 11) lidhur me Nenet 20 dhe 23 të KPK, që mundëson shqiptimin e dënimit penal tri të katërtat e së pakut dhjetë vjet burgim dhe për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve, në shkelje të Nenit 328, Paragrafi (2) i Kodit Penal të Kosovës (KPK) në bashkim real me veprat penale të përshkruara më lartë, që mundëson shqiptimin e gjobës deri në 7500 Euro apo burgim prej një deri në tetë vjet,
- Bashkim Igrishta për Vrasje në Tentativë në shkelje të Nenit 146 të KPK lidhur me Nenin 20 të KPK, që mundëson shqiptimin e dënimit penal prej tri të katërt nga së pakut pesë vjet burgim dhe



- Xhemë Igrishta për Kanosje në shkelje të Nenit 161 Paragrafi (4) lidhur me Paragrafin (2) të KPK, që mundëson shqiptimin e një gjobe apo burgim deri në dy vjet.

Aktakuza pretendon se të Akuzuarit i kanë kryer veprimet kriminale në Mitrovicë që gjindet në kuadër të Qarkut të Mitrovicës.

Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është organi kompetent gjyqësor për ta zhvilluar këtë procedurë penale.

### **C. Kualifikimi Ligjor – Ligji i aplikuar**

Në pajtim me Nenin 2 Paragrafi (1) dhe (2) i KPK, ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale do të aplikohet për kryerësin përveç nëse një ligj i ri është më i favorshëm për të akuzuarit. Veprimet kriminale janë kryer më 04 Dhjetor 2009 nën Kodin e ri Penal të Kosovës (KPK) që ka hyrë në fuqi më 06 Janar 2009.


### **D. Dëshmitë**

Gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor janë dëgjuar këta dëshmitarë:

- 1) Fata Igrishta
- 2) Jashar Sadiku
- 3) Ramadan Goxhuli
- 4) Faik Kajtazi
- 5) Rafet Ibrahim
- 6) Selim Mehulli
- 7) Visar Mehulli
- 8) Miradije Goxhuli

Gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor gjyqësor është bërë një vendshiqim me datën 20 Tetor 2011 në Rrugën Ulqini në Mitrovicë në prani të Prokurorit Publik të EULEX-it Adebayo Kareem, të të Akuzuarëve Safet Goxhuli, Agron Goxhuli, Ahmet Goxhuli dhe Bashkim Igrishta, Avokatëve të tyre Mbrojtës Bajram Kajtazi, Bashkim Mehana, Haxhi Millaku dhe Agim Lushta dhe në prani të dëshmitarëve Faik Kajtazi dhe Rafet Ibrahim.

Gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor gjyqësor, janë lexuar dhe futur në dëshmi këto dokumente:



- 1) Laboratori i Forenzikës, Sektori i Shenjave të Armëve të Zjarrit dhe Veglave: Raporti i Ekspertit (faqe 50 – 56 në vëllimin I)
- 2) Raporti GSR i datës 17 Maj 2010 (faqe 64 – 67 në vëllimin I)
- 3) Raporti i Autopsisë i Makfire Sadikut (faqe 95 – 105 në vëllimin I)
- 4) Kallximi Penal Policor (faqe 9 në vëllimin II)
- 5) Foto albumi (faqes 23 – 109 në vëllimin II)
- 6) Shënim Zyrtar Policor (faqe 165 në vëllimin II)
- 7) Raporti i Policit (faqe 169 në vëllimin II)
- 8) Raporti i Policit (faqe 171 në vëllimin II)
- 9) Kërkesa për raport balistik (faqe 185 në vëllimin II)
- 10) Raportet Laboratorike (faqe 193, 199 – 206 në vëllimin II)
- 11) Urdhëri i Gjykatës lidhur me raportin balistik (faqe 208 në vëllimin II)
- 12) Raporti Fillestar nga Policët Rafet Ibrahimimi dhe Faik Kajtazi (faqe 239 në vëllimin II)
- 13) Raporti i Policit (faqe 247 në vëllimin II)
- 14) Lista e armëve të konfiskuara nga Agron Goxhuli (faqe 304 në vëllimin II)
- 15) Lista e armëve të konfiskuara nga Safet Goxhuli (faqe 308 në vëllimin II)
- 16) Lista e armëve të konfiskuara nga Ahmet Goxhuli (faqe 310 në vëllimin II)
- 17) Forma e Përshkimit Mjekësor e Ahmet Goxhulit (faqe 326 në vëllimin II)
- 18) Raporti Mjekësor lidhur me shërimin e Bashkim Igrishtës (faqe 8 in volume III)
- 19) Fotografitë e lëndimeve të Bashkim Igrishtës (faqe 10 në vëllimin III)
- 20) Raporti i Hetuesit (faqe 14 – 15 në vëllimin III)
- 21) Raporti nga Ekzaminimi i Vendi të Ngjarjes (faqe 20 – 27 në vëllimin III)
- 22) Lista e Dëshmimeve (faqes 28 – 33 në vëllimin III)
- 23) Skica e vendit të ngjarjes (faqe 34 – 36 në vëllimin III)
- 24) Lista e dëshmimeve (faqe 78 në vëllimin III)
- 25) Fotografitë e të pandehurëve (faqe 90 – 93 në vëllimin III)
- 26) Raporti Preliminar i autopsisë i Isa Igrishtës (faqe 94 – 95 në vëllimin III)
- 27) Fotografitë lidhur me autopsinë e Isa Igrishtës (faqe 99 – 193 në vëllimin III)
- 28) Raporti Preliminar i autopsisë i Makfire Sadikut (faqe 193 – 194 në vëllimin III)
- 29) Foto album lidhur me Makfire Sadikun (faqe 198 – 280 në vëllimin III)
- 30) Administrimi i Dëshmimeve lëshuar nga qendra mjekësore në Vushtrri (Mbështjellësi III i shkresave të gjykatës)
- 31) Dosja Mjekësore e Ahmet Goxhulit nga Qendrat e Paraburgimit në Gjilan dhe Dubravë (Mbështjellësi III i shkresave të gjykatës)



Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, i Akuzuari Bashkim Igrishta më 01 Nëntor 2011 dhe i akuzuari Safet Goxhuli më 02 Nëntor 2011 kanë dhënë deklaratat e tyre dhe u janë përgjigjur pyetjeve. Xhemë Igrishta, Agron Goxhuli dhe Ahmet Goxhuli janë mbrojtur në heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor.

#### **E. Përmbledhje e Dëshmive të paraqitura/ konstatimeve faktike**

Historiku i incidentit që ka ndodhur në Rrugën Ulqini në Mitrovicë më 04 Dhjetor 2009 është për shkak të një marrëdhënje të pretenduar seksuale ndërmjet dy fçinjëve Makfire Igrishta dhe Musa Goxhuli. Sipas Ramadan Goxhulit, fçinjë i familjes Igrishta për 12 vjet, nuk ka pasur incident ndërmjet këtyre familjeve gjerë më tani. Familjet Igrishta dhe Goxhuli nuk janë shoqëruar me njëra tjetrën përveç festimeve të rëndësishme. Gjatë shqyrtimit gjyqësor është konfirmuar se tensionet kishin filluar kur Xhemë Igrishta i kishte treguar vëllaut të tij Bashkim Igrishtës, që ishte liruar nga burgu se gjatë kësaj kohe gruaja e tij Makfire Igrishta kishte pasur marrëdhënje seksuale me djalin e Ramadan Goxhulit, Musa Goxhulin.

**Xhemë Igrishta** është mbrojtur në heshtje gjatë hetimit policor kur ishte intervistuar më 04 Dhjetor 2009 siç ka vepruar edhe gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor.

**Ramadan Goxhuli** ka deklaruar se në mëngjesin pas Bajramit të vitit 2009, Bashkim Igrishta kishte ardhur te shtëpia e Goxhulëve dhe e kishte detyruar që të shkonte te shtëpia e tij në Bajr. Gjerësa ishte në shtëpinë e tij, Bashkim Igrishta kishte nxjerrë një revole nga brezi dhe e kishte vënë mbi tavolinë. Ai e kishte njoftuar Ramadan Goxhulin për marrëdhënjen e pretenduar seksuale ndërmjet Makfire Igrishtës dhe Musa Goxhulit. Makfire Igrishta ishte e pranishme dhe dukej sikur të ishte rrahur. Ramadan Goxhuli ka mohuar marrëdhënjen e pretenduar. Bashkim Igrishta kishte kërkuar 25,000 Euro për ta zgjidhur këtë problem. Bashkim Igrishta kishte premtuar se do ta caktonte një datë për pagesë dhe i kishte thënë Ramadan Goxhulit “ ju duhet t'i jepni paratë, nëse jo duhet të shpërnguleni nga shtëpia juaj. *Duheni të shpërnguleni.*” Posa arriti në shtëpi Ramadan Goxhuli, e thirri djalin e tij Safet Goxhulin. Askush tjetër nuk ishte në dijeni për këtë problem. Më vonë, Ramadan Goxhuli dhe Safet Goxhuli u takua me Jashar Sadikun, babai i të ndjerës Makfire Igrishta. Ata e kanë ftuar atë në “odë” ku më vonë kishte shkuar Bashkim Igrishta. Ramadan Goxhuli u ka thënë Igrishtëve se ai nuk u kishte borxh asgjë atyre. Pasiqë kishte eskaluar situata, Ramadan Goxhuli kishte shkuar me Safet Goxhulin dhe Jashar Sadikun në polici




me qëllim që t'i raportojnë Igrishtët. Policia i kishte rekomanduar Ramadan Goxhulit që ta gjente një ndërmjetësues për ta zgjidhur mosmarrveshjen.

**Selim Mehulli** kishte vepruar si ndërmjetësues, me kërkesën e Ramadan Goxhulit, ndërmjet familjeve Goxhuli dhe Igrishta javën pas Bajramit të vitit 2009. Ai kishte vizituar Isa Igrishtën dy apo tri herë. Edhe pse ata ishin gadi kah e zgjidhin problemin, familja Igrishta vazhdonte të distancohej nga familja Goxhuli. Selim Mehulli ishte takuar me Isa Igrishtën. Ai kishte provuar ta bind atë duke i thënë, *"le të betohet me njëzetekatër pleq se nuk ka hile në këtë"*. Së pari, Isa Igrishta sygjeroi që Ramadan Goxhuli duhet të betohet për të cilën gjë ai ishte përgjigjur se *"nëse ka nevojë unë do t'i sjell 150 pleq. Unë betohem për këtë me 150 pleq"*. Sipas Selim Mehullit, ata arritën ta caktojnë një datë për të shkuar në xhami dhe për t'u betuar por kjo kishte dështuar. Pastaj Isa Igrishta kishte sygjerruar se nëse familja Goxhuli e lëshon shtëpinë, ata do të mund të vinin deri te një marrëveshje. Ramadan Goxhuli iu kishte përgjigjur kësaj oferte duke thënë, *"nëse ka nevojë, unë do ta lëshoj shtëpinë, sepse nuk dua të kem ndonjë problem. Ai mund t'i marrë tre njerëz, që do ta vlerësojnë vlerën e shtëpisë. Isa mund t'i jap paratë dhe unë do ta lëshoj shtëpinë."* Isa Igrishta kishte refuzuar. Një apo dy ditë më vonë Isa Igrishta bashk me disa njerëz të tjerë dhe me djalin e tij kishin ardhur te shtëpia e Selim Mehullit dhe i kishin thënë *"kjo çështje nuk mund të zgjidhet në mënyrën që ju mendoni se duhet të jetë"*. Si pasojë Selim Mehulli u përgjigj se ndërmjetësimi kishte dështuar dhe kishte mbaruar atë ditë duke e njoftuar Ramadan Goxhulin.

**Dëshmitari Visar Mehulli** ka treguar se kishte qenë me babain e tij te shtëpia e Isa Igrishtës por nuk i kishte dëgjuar bisedat ndërmjet ndërmjetësuesit dhe të tjerëve.


**Dëshmitari Jashar Sadiku** ka deklaruar se kishte pasur biseda lidhur me e sjelljen e dhunshme të pretenduar të Xhemë Igrishtës dhe keqtrajtim seksual të Makfire Igrishtës para incidentit më 04 Dhjetor 2009. Ne kemi dëgjuar për herë të parë lidhur me marrëdhënjen e pretenduar ndërmjet vajzës së tij Makfires dhe Musa Goxhulit një muaj para se të vdiste vajza e tij. Ai tregoi se kishte vizituar Ramadan Goxhulin dhe djalin e tij Musën për t'i pyetur nëse pretendimet janë të vërteta të cilën gjë ata e kishin mohuar. Ditën e Hënë, pas Bajramit, Ramadan Goxhuli kishte ardhur me një djal të ri për ta marrë atë dhe për të shkuar në shtëpinë e vajzës së tij në Bajr ku ishin mbledhur dymbëdhjetë njerëz. Selim Mehulli ishte aty si ndërmjetësues. Ai e kishte informuar atë për dëshirat e Isa Igrishtës që Goxhulët duhej ta *"lëshonin shtëpinë për t'u pajtuar"*. Sipas Jashar Sadikut, vajza e tij i kishte thënë të nesërmen se ajo kishte pasur marrëdhënje



seksuale me Musa Goxhulin. Megjithatë Jashar Sadiku tha se ajo po gënjente sepse ishte e shokuar dhe nuk dinte se çka po thonte. Ai nuk ka qenë i pranishëm në rrugën Ulqini Street në Mitrovicë më 04 Dhjetor 2009

**Dëshmitarja Miradije Goxhuli**, gruaja e Ramadan Goxhulit deklaroi se një ditë Bashkim Igrishta kishte vizituar shtëpinë e tyre dhe kishte kërkuar nga Ramadan Goxhuli që të shkonte me të për të diskutuar lidhur me mosmarrëveshjen. Miradije Goxhuli nuk kishte shkuar me burrin e saj. Ramadan Goxhuli i kishte thënë asaj mëpastaj se Bashkim Igrishta kishte kërkuar nga ai 25,000 Euro. Ajo citoi fjalët e burrit të saj "Nëse nuk don të mi japish paratë, unë do të ju qes nga shtëpia." Ajo tha se pas takimit me Bashkim Igrishtën, Ramadan Goxhuli ishte takuar me Jashar Sadikun. Asaj i kujtohet se Ramadan Goxhuli e kishte lajmëruar incidentin në polici dhe e kishte dërguar Selim Mehollin për t'u pajtuar. Miradije Goxhuli nuk kishte parë asgjë të ketë pasur lidhje të drejtëpërdrejtë me pajtimin apo me incidentin që kishte ndodhur më 04 Dhjetor 2009.


**Ramadan Goxhuli** ka deklaruar se më 04 Dhjetor 2009 rreth orës 11:30 min, djali i tij Safet Goxhuli kishte ardhur në shtëpinë e tij me Agron Goxhulin. Ahmet Goxhuli kishte qenë aty. Kur kanë dalur nga shtëpia, ai kishte ecur para djalit të tij Safetit dhe Igrishta ishte duke i pritur ata te dyert. Ramadan Goxhuli ka deklaruar se posa kishte dalur Safet Goxhuli Isa Igrishta e kishte kapur për krahu dhe e kishte pyetur se a kishte ndonjë gjë për të treguar. Ramadan Goxhuli nuk mund t'i dëgjonte se për çka po bisedonin por në ndërkohë aty kishin ardhur me veturë Bashkim Igrishta dhe gruaja e tij Makfire Igrishta. Ata të dy kishin dalur nga vetura, Makfire Igrishta bërtiste. Ata kishin kërcyer në shpinën e djalit të tij dhe e kishin goditur Ramadan Goxhuli i kishte kërkuar që ata të dilnin nga aty. Bashkim Igrishta ishte dalur me gruan e tij por Safet Goxhuli kishte vazhduar të kacafytej me Isa Igrishtën. Ramadan Goxhuli i kishte rënë shuplakë djalit të tij Safetit tri herë dhe e kishte urdhëruar që të ndalej. Pas tre apo katër minutash Bashkim Igrishta ishte kthyer me veturën e tij BMW, me një shpejtësi të madhe. Ramadan Goxhuli ka cituar paralajmërimet që kishte dëgjuar "Ruajuni se do të ju godet!" Sipas tij, Agron dhe Ahmet Goxhuli ishin larguar duke kërcyer në skajin e rrugës. Bashkim Igrishta e kishte ngarë veturën në drejtim të Ahmet Goxhulit i cili ishte bllokuar te muri dhe ishte rrëzuar nën veturë. Ramadan Goxhuli e kishte kapur kokën kur e kishte dëgjuar Ahmetin duke bërtitur "Çka po bënë?" dhe nuk kishte mundur të shihte se çka kishte ndodhur më vonë. Ai ka treguar se nuk kishte dëgjuar ndonjë të shtënë me armë edhe pse kur ishte ardhur e kishte parë Isa Igrishtën të shtrirë në tokë rreth dhjetë metra larg prej tij. Ramadan Goxhuli ka cekur se Xhemë Igrishta nuk iu kishte kanosur një ditë para datës 04 Dhjetor 2009.



**Dëshmitari Faik Kajtazi**, polic trafiku, ka deklaruar se ishte në detyrë në Mitrovicë me Rafet Ibrahimin me datën 04 Dhjetor 2009 rreth orës 12:25. Ai kishte parë një njeri duke ngarë një BMW të kuqe me një femër si pasagjere. Ata ishin ndalur dhe ju kishin thënë *“Disa njerëz po vrasin njëri tjetrin derisa ju po rrini këtu. Çka jeni duke bërë këtu?”* Shoferi i BMW-së ishte bërë një *gjysëm rrethi* në mënyrë shumë agrsive në udhëkryq dhe kishte ngarë veturën në drejtim të Shipolit në magjistralen e Ulqinit në drejtim të fshatit Zhabar. Faik Kajtazi dhe kolegu i tij i kishin shkuar pas në një distancë prej rreth 150 deri 200 metra. Ata kishin mundur ta shihnin BMW-në e kuqe gjatë tërë kohës. Faik Kajtazi ka deklaruar se e kishte parë BMW-në që po shkonte nga ana e djathtë në anën e majtë të rrugës dhe kishte hyrë në një rrugicë me baltë, pastaj ishte ngjitur në një rrugë me zhavorr, duke e ulur shpejtësinë. Faik Kajtazi ka deklaruar se kishte parë pesë apo gjashtë njerëz duke qëndruar në rrugën e sipërme kur kishte arritur BMW-ja e kuqe dhe kishte goditur një njeri me mjekërr. Shoferi kishte goditur një person me pjesën e përparme të veturës. Njeriut iu kishte dashur të mbështetet për një muri afër tij. Në ndërkohë Faik Kajtazi, pasi kishte ndalur veturën e policisë në anën e djathtë të magjistralës, kishte dëgjuar të shtëna armësh dhe kishte kuptuar se një person ishte rrëzuar në tokë. Mëpastaj, kishte dëgjuar të shtëna tjera armësh. Faik Kajtazi ka deklaruar se pas marrëveshjes me kolegun e tij, kishte marrë anën e djathtë të rrugës dhe kolegu i tij anën e majtë të rrugës. Kishte vrapuar i kërrusur dhe kishte shkuar te muri sipër magjistrales ku kishte zënë pozitën. Ai kishte parë dy njerëz që po rrinin para tij, njëri nga ta mbante një revole. Ai kishte bërtitur urdhëra verbal *“Stop, kjo është policia. Hudhe armën.”* Njeriu që kishte armën e ka hedhur atë pa ndonjë rezistencë, ai e kishte urdhëruar atë të shtrihet në tokë dhe e kishte prangosur. Edhe tjerëri u shtrinë në tokë. Nga vendi i tij, ai e kishte parë BMW-në e kuqe të parkuar dhe një një person tjetër me një armë diku rreth pesëmbëdhjeta apo njëzet metra larg tij. Ai i kishte dhënë atij urdhërin e njëjtë verbal. Ai kishte parë edhe një grua që ishte e shtrirë në tokë afër veturës.

I pyetur lidhur me distancën ndërmjet njerëzve në vendin e krimit, Faik Kajtazi ka deklaruar se personi me mjekërr që ishte goditur nga vetura ishte rreth shtatë deri tetë metra largë personit që ishte rrëzuar në tokë pas të shtënës.


**Dëshmitari Rafet Ibrahimimi**, polic, ka deklaruar se njeriu në BMW-në e kuqe i shoqëruar nga një femër ishte ndalur para tyre dhe kishte kërkuar nga ata që t'i shkonin pas gjë që ata e bënë nga distanca pasi që BMW-ja e kuqe ishte shumë e shpejtë dhe e rrezikshme. Prapseprap ata ishin mjaft afër që ta shihnin veturën. Në një moment, BMW-ja e kuqe e lëshoi magjistralen dhe u kthye në të



majtë në një rrugë të ngushtë. Rafet Ibrahimimi e kishte parkuar veturën e policisë në anën e djathtë të magjistrales. Në ndërkohë ai kishte parë një grup njerëzish duke qëndruar në një rreth dhe BMW-në që kishte goditur një njeri me mjekër, dhe e kishte shtyrë atë për muri me pjesën e përparme të majtë. Viktima ia doli që ti vejë duart në kapakun e motorit por kishte mbetur nën veturë. Ai e kishte kuptuar se diçka serioze ishte duke ndodhur. Gjerësa po hapte derën, kishte dëgjuar të shtëna armësh. Rafet Ibrahimimi ka vazhduar të ec në këmbë nëpër rrugën dytësore me zhavorr. Ai kishte parë BMW-në e kuqe duke u kthyer në anën e majtë pas një shtylle, ku ishte parkuar. Rafet Ibrahimimi kishte shkuar te këndi i rrugës gjerësa kolegu i tij ishte afruar te vija e zjarrit. Rafet Ibrahimimi e ka cituar Faik Kajtazin t'i ketë paralajmëruar njerëzit "*Kjo është policia, stop*". Rafet Ibrahimimi kishte përsëritur të njëjtin urdhër nga një distancë prej pesë apo gjashtë metrash nga vendi ku po qëndronin dy njerëz. Një njeri i armatosur e kishte hudhur armën. Rafet Ibrahimimi ka deklaruar se e kishte prangosur personin e armatosur dhe e kishte mbajtur nën kontroll personin tjetër, ai ishte më i madhë se sa ai, topolak, jo i trashë, por trupngjeshur, tip bjond. Ai kishte parë një femër të shtrirë në tokë afër BMW-së së kuqe pran derës së ulëses së pasagjerit.

Të dy policët kanë deklaruar se kishin parë dy njerëz që po vinin në drejtim të tyre pasi kishin dhënë identifikimin e tyre si polic dhe kishin ofruar ndihmë. Rafet Ibrahimimi gjithashtu ka deklaruar se i kishte arrestuar dy njerëz tjerë, të cilët ishin fçinjë. Njëri nga ta ishte person i moshuar që mbante një beretë të zezë në kokë dhe tjetri ishte më i ri. Ai nuk kishte mundur ta shihte shoferin e BMW-së së kuqe derisa kishte shkuar një njësi tjetër e policisë dhe e kishte marrë atë jashtë shtëpisë ku kishte ikur. Rafet Ibrahimimi ka deklaruar se kur kishte ardhur njësia tjetër e policisë në vendngjarje ata kishin gjetur një armë në trupin e personin me mjekër. Ai kishte vërejtur disa dëme në mbrojtësin e BMW-së së kuqe.

**Bashkim Igrishta** ka deklaruar se me datën 04 Dhjetor 2009 rreth orës 11:00 para dite, kishte qenë duke e ngarë veturën me gruan e tij Makfire Igrishta për në shtëpinë e babait të tij. Kur kishte arritur aty, së pari kishte parë Safet Goxhulin, pastaj Agron Goxhulin dhe mëpastaj Ahmet Goxhulin që po vinin në drejtim të veturës së tij. Ramadan Goxhuli vinte pas tyre. Bashkim Igrishta ka treguar se Safet Goxhuli i kishte thënë atij "*Mos lëviz se përndryshe ta qi nanën dhe ta heqi kokën*" dhe ai ishte përgjigjur, "*gjuaj sepse fare nuk po frikohem*" dhe pas kësaj Safet Goxhuli e kishte goditur me grusht në hundë. Pastaj Agron Goxhuli e kishte shtyrë Bashkim Igrishtën për muri. Isa Igrishta kishte tentuar t'i ndajë por Safet Goxhuli e kishte goditur Isa Igrishtën me dorëz të revoles. Bashkim Igrishta ka deklaruar se nuk kishte mundur ta gjente numrin e policisë andaj e kishte ngarë veturën në drejtim të qendrës së qytetit. Ai ishte ndalur te një patrollë e policisë



dhe u kishte thënë se tre persona po ia rrezikonin jetën babait të tij me armë. Policia e kishte përcjellur atë në një distancë prej rreth pesëdhjetë metrash. Pra se të arrinin në vendin ku kishte ndodhur incidenti, ende në rrugën e asfaltuar, Bashkim Igrishta kishte dëgjuar një të shtënë arme por nuk kishte parë asgjë. Ai ka deklaruar se kur kishte arritur te babai i tij, kishte humbur kontrollin ndaj veturës dhe kishte vërejtur se Ahmet Goxhuli ishte duke shtënë në drejtim të tij, tri herë gjerësa babai i tij ishte në tokë. Bashkim Igrishta ka deklaruar se nuk kishte mundur ta ndalte veturën e tij sepse ishte shumë afër nga vendi ku po qëndronin njerëzit. Prandaj, ai ishte larguar duke ngar veturën dhe kishte parë Ahmet Goxhulin që kishte shtënë në të në kyçin e dorës së majtë. Pastaj kishte humbur kontrollin dhe nuk ishte më i vetëdijshëm për situatën. Ai e ka pranuar se vetura e tij e kishte goditur dikend. Ai ka thënë se kur kishte dalur nga vetura Safet, Agron dhe Ahmet Goxhuli kishin vrapuar në drejtim të tij dhe kishin shtënë në të. Bashkim Igrishta kishte kërcyer përtej murit të oborrit të tij dhe ishte fshehur atje. Ai kishte dëgjuar që ishte hapur dera e veturës së tij dhe e kishte dëgjuar gruan e tij duke bërtitur "lëshomi flokët" dhe mëpastaj një zë të papërcaktuar duke bërtitur "jo gruan". Pastaj kishte dëgjuar tri të shtëna armësh por nuk kishte parë asgjë. Policia e kishte gjetur dhe e kishte dërguar në Klinikën Univerzitare në Prishtinë. Bashkim Igrishta ka deklaruar se as babai i tij dhe as grua e tij nuk kanë pasur armë në ditën kritike.


**Safet Goxhuli** ka deklaruar se e njihnte Bashkim Igrishtën pasi që ai ishte djali i fçiut të tij por kurrë nuk ishte shoqëruar me të. Më 04 Dhjetor 2009 ai ishte kthyer nga puna në ora 8:30 të mëngjesit dhe e kishte dërguar veturën te mekaniku. Pasi kishte pasur nevojë për para e kishte thirrur Agron Goxhulin që me veturë ta dërgonte deri te shtëpia e Ahmet Goxhulit që ti kërkojë paratë. Meqë Ahmet Goxhuli nuk kishte qenë në shtëpi, ata kishin shkuar te shtëpia e Ramadan Goxhulit ku Ahmeti kishte qenë duke pritur kohën për t'u falur. Ata kishin dalur të gjithë së bashku nga shtëpia e Ramadanit dhe e kishin parë Isa Igrishtën te dera e shtëpisë së tyre i cili iu kishte thënë "Pse keni ardhur këtu? Ju duhet ta lëshoni këtë shtëpi, merrni familjen dhe dilni nga këtu." Safet Goxhuli ishte përgjigjur, "Babai im ka dërguar një ndërmjetësues tek ju. Sa i përket kërkesës suaj për ta lëshuar shtëpinë tonë, unë i kam dërguar njerëzit dhe do të përgjigjem si të duash." Isa ishte përgjigjur: "Unë kërkova që ta lëshoni shtëpinë dhe nuk jam i interesuar për ata njerëz. Do të ju tregojë për dy minuta se do të ju detyroj me forcë që ta lëshoni shtëpinë." Gjatë bisedës, Ramadan Goxhuli i kishte rënë shuplakë djalit të tij i cili ishte mosrespektues ndaj Isa Igrishtës. Në ndërkohë, kishin ardhur me veturë Bashkim Igrishta dhe Makfire Igrishta dhe Isa Igrishta i kishte thënë djalit të tij, "Qija nanën vraje, shkele me veturë." Bashkim Igrishta dhe Makfire Igrishta kishin dalur nga vetura, e kishin kapur për xhakete, e kishin



kapur për fyti dhe e kishin larguar nga dyert. Safet Goxhuli i kishte rënë grusht në vetëmbrojtje. Ai ka cekur se Agron dhe Ahmet Goxhuli nuk kishin ditur për çka ishte e tërë kjo sepse nuk i njihnin fçinjët. Safet Goxhuli ishte ndarë nga Isa Igrishta; ata kishin vazhduar bisedën. Bashkim dhe Makfire Igrishta ishin larguar me veturë. Ata ishin kthyer me policinë pas pesë minutash. Safet Goxhuli ka deklaruar se Bashkim Igrishta kishte shpejtuar veturën e tij në rrugën me zhavorr në drejtim të grupit. Ata kishin ikur anash përveç Ahmet Goxhulit i cili ishte shtyrë për muri. Safet Goxhuli kishte dëgjuar të shtënat dhe e kishte parë Ahmet Goxhulin që ishte tërhequr, i rrëzuar dhe i vjerrur në pasqyrën e veturës. Ai gjithashtu e kishte parë Isa Igrishtën duke shtënë në veturën që e kishte të hapur dritaren e pasagjerit. Pastaj, Isa Igrishta kishte kthyer revolen në drejtim të Safet Goxhulit. Në ndërkohë Isa Igrishta e kishte ngre çarkun e armës dhe kishte futur një fyshek tjetër në tytë, Safet Goxhuli në vetëmbrojtje kishte shtënë pa kontroll. Atij nuk i kujtohej se sa herë kishte shtënë por insistonte në faktin se nuk kishte dashur ta vriste atë. Kur ishte rrëzuar Isa Igrishta në tokë, revolja i kishte rënë afër Ahmet Goxhulit. Safet Goxhuli ka treguar se me shqelm e kishte larguar armën nga Isa Igrishta në drejtim të Ahmetit i cili e kishte marrë atë. Safet Goxhuli ka deklaruar se BMW-ja e kuqe ishte ndalur te një derë e vogël. Ai e kishte parë Makfire Igrishtën ulur në dy gjunjët e saj. Në kohën kur Xhemë Igrishta ishte te dera me armë; në ndërkohë nëna e tij Fata Igrishta e kishte kapur dhe i kishte thënë "*Largohu, tani po vjen policia!*" Sipas pikëvështrimit të Safet Goxhulit, Xhemë Igrishta ose Isa Igrishta kanë shtënë në Makfire Igrishtën.

Safet Goxhuli ka deklaruar se ai e kishte sjellur armën e tij nga Shqipëria si relik të luftës dhe e mbante për ta mbrojtur veten nga qentë, shtazët e egra dhe njerëzit. Ai ka punuar me ndërrime në KEK dhe i duhej të ecte nëpër male që të arrijë deri te vendndalja e autobusit. Ai e ka pranuar se nuk kishte leje për armë.

**Agron Goxhuli** i ka treguar prokurorit më 14 Dhjetor 2009 se kishte dalur nga shtëpia më datën 04 Dhjetor 2009 kur Safet Goxhuli e kishte lutur që ta vizitonin Ramadan Goxhulin në Mitrovicë. Ata kishin shkuar me veturë te shtëpia e Ahmet Goxhulit së pari për të kërkuar ca para për Safet Goxhulin por ai tashmë ishte nisur për në shtëpinë e Ramadan Goxhulit. Te shtëpia e Ramadanit, të pranishëm ishin Ramadan Goxhuli, gruaja e tij Miradije Goxhuli, Arton Goxhuli, gruaja e ti dhe Ahmet Goxhuli. Ata nuk kishin biseduar për mosmarrëveshjen ndërmjet familjeve të Ramadan Goxhulit dhe Isa Igrishtës. Ai ishte brenda në oborr kur e kishte parë Safet Goxhulin duke biseduar me Isa Igrishtën por nuk e kishte dëgjuar bisedën. Kur kishte arritur te dyert e oborrit e kishte parë Bashkim Igrishtën që po e ngiste veturën në drejtim të Safet Goxhulit. Agron Goxhuli e kishte dëgjuar Isa Igrishtën dhe Bashkim Igrishtën t'i kenë thënë " Të kam thënë



se nuk dua të ju shoh këndeje pari, ti duhet ta lëshoshë shtëpinë sepse na keni turpëruar”. Safet Goxhuli ishte përgjigjur “ Unë nuk kam asgjë lidhur me këtë, ne nuk ju kemi asgjë borxh lidhur me këtë çështje”. Menjëherë pas kësaj, Isa Igrishta, Bashkim Igrishta dhe Makfire Igrishta kishin filluar ta grushtonin Safet Goxhulin. Ata goditnin njëri tjetrin. Agron Goxhuli kishte dëgjuar Isa Igrishtën duke i thënë djalit të tij që të del nga shtëpia. Safet Goxhuli kishte vazhduar të bisedojë me babain e tij dhe fçiun e tij jasht dyerëve. Ahmet Goxhuli dhe ai vetë po qëndronin rreth pesëmbdhjetë metra larg nga Isa Igrishta, Ramadan dhe Safet Goxhuli. Agron Goxhuli e kishte parë Bashkim Igrishtën duke e shkelur Ahmet Goxhulin me veturë, duke e shtypur për muri. Në të njëjtin moment kishte dëgjuar të shtënat e armëve dhe kishte menduar se Isa Igrishta kishte shtënë në Ahmet Goxhulin. Agron Goxhuli ka thënë se si reagim, ai e kishte nxjerrur armën dhe kishte shtënë në ajër katër deri pesë herë duke mos specifikuar drejtimin. Ai ka deklaruar se kishte trembëdhjetë fyshek me vete dhe pesë fyshek i kishte në armën e tij. Kur polici e kishte urdhëruar që ta lëshojë armën , ai iu kishte përmbajtur urdhërit.

Agron Goxhuli i ka treguar policisë se shoferi i BMW-së së kuqe ishte pa flokë por nuk e kishte njohur. Agron Goxhuli ka deklaruar se me vete e kishte revolën e tij, Zastava TT, ngjyrë të bardhë. Ai ka thënë se gjithëmonë e bante revolën me veti si kujtim të luftës. Ai nuk kishte parë armë te ndonjë person tjetër. Ai nuk e dinte nëse Ahmet Goxhuli kishte zakon të mbante armë.

**Ahmet Goxhuli** i ka deklaruar prokurorit më 19 Shkurt 2010 se me datën 04 Dhjetor 2009 e kishte vizituar Ramadan Goxhulin para se të shkonte ta falte namazin e gjumasë. Ai kishte ndejtur atje rreth një orë. Gjatë vizitës Ramadan Goxhuli i kishte treguar atij për mosmarrëveshjen me Isa Igrishtën. Kur ishte dalur, atë e kishin përcjellur deri te dera, Ramadan Goxhuli, Agron Goxhuli dhe Safet Goxhuli. Isa Igrishta ishte te dera. Safet Goxhuli i kishte thënë atij “*Isë, fçi im, Unë t’i kam dërguar njerëzit e mi për pajtim*”. Bashkim Igrishta dhe Makfire Igrishta kishin dalur nga vetura dhe Bashkimi i kishte thënë Safet Goxhulit “ *Më duhet ta shkurorëzojë këtë grua për shkakun tuaj.*” Makfire Igrishta kishte pyetur për Vëllaun e Safetit. Safet iu kishte përgjigjur “*Po të kishe patur fytyrë, nuk do të kishe dalur dhe turpëruar veten.*” Në këtë moment kanë filluar ta shtynin njëri tjetrin. Bashkim Igrishta i kishte thënë Safetit se nuk do të mbetej kështu. Isa Igrishta, Ramadan Goxhuli dhe Safet Goxhuli kanë vazhduar bisedën. Me sa dukej Bashkim Igrishta kishte hyrë në rrugë duke ngarë BMW-në e kuqe me shpejtësi dhe e kishte goditur me pjesën e përparme të veturës së tij. Ahmet Goxhulit nuk i kujtohej nëse ishte rrotulluar mbi kapakun e veturës apo ishte shtyrë për muri. Ai e kishte humbur vetëdijen. Ai kishte tentuar të ngritej në



këmbë por nuk kishte mundur dhe ishte rrëzuar prap. Ai kishte dëgjuar disa të shtëna armësh por nuk e kishte ditur prej kah kishin ardhur ato. Pasi iu kishte kthyer vetëdija e kishte gjetur një armë shumë afër tij, e kishte marrë atë dhe e kishte futur në brez. Ahmeti ka deklaruar se kur e kishte goditur vetura, Isa Igrishta ishte duke qëndruar rreth dy metra më larg. Ka ardhur policia dhe ai e ka dorëzuar armën. Ahmet Goxhuli ka treguar se kishte pësuar lëndime trupore në të dy këmbët, nën dhe mbi gjunjë, në anën e majtë të kombikut të tij, shtypje në gjoks dhe tronditje në kokë. Ai kishte vjellur gjithashtu. Ai kishte qenë nën terapi dhe kishte marrë barna pas incidentit. Ahmet Goxhuli e ka mohuar se kishte shtënë në ndokend. Ai gjithashtu ka deklaruar se nuk kishte parë dikend tjetër me armë.

## F. Vlerësimi i dëshmimeve të paraqitura


### I. Për dëshmitë e datës 03 Dhjetor 2009

Dëshmitë lidhur me **Xhemë Igrishën** i akuzuar për kanosje kundër Ramadan Goxhuli dhe Musa Goxhuli më 03 Dhjetor 2009.

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, as pala e dëmtuar Ramadan Goxhuli dhe as dëshmitarët nga familaja Goxhuli nuk kanë lajmëruar se Xhemë Igrishta ka bërë kanosje më 03 Dhjetor 2009 ndaj Ramadan apo Musa Goxhulit. Përkundrazi, Ramadan Goxhuli formalisht ka mohuar se ka pësuar ndonjë kanosje nga Xhemë Igrishta. Sa i përket Musa Goxhulit, që nuk ishte prezent në shqyrtimin gjyqësor (jeton jasht vendit), nuk ka ndonjë dëshmi në dosje, apo element që është sjellur nga dëshmitarët gjatë seancave dëgjimore për ta mbështetur pretendimin e kanosjes ndaj tij. E vetmja deklaratë e Musa Goxhulit që gjindet në shkresat e lëndës mban datën e 30 Nëntorit 2009, tri ditë para kanosjes së pretenduar. Pastaj nuk ka deklarata tjera nga Musa Goxhuli i cili aktualisht jeton jasht vendit.

Për shkak të mungesës së dëshmimeve kundër Xhemë Igrishtës për të mbështetur pretendimet se ai iu kishte kanosur Ramadan Goxhulit dhe Musa Goxhulit më 03 Dhjetor 2009, në pajtim me Nenin 390 Pika 3) e KPPK, gjykata e liron Xhemë Igrishtën nga akuzat e kanosjes, në kundërshtim të Nenit 161 Paragrafi 4 lidhur me Paragrafin 2 të KPK.

### II. Për faktet e datës 04 Dhjetor 2009




Sipas dëshmimeve të paraqitura gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor gjyqësor, Gjykata konsideron se janë vërtetuar këto fakte:

Më 04 Dhjetor 2009 rreth orës 12.30, në rrugicën e familjeve Goxhuli dhe Igrishta në Mitrovicë, për shkak të një marrëdhënje të pretenduar seksuale ndërmjet dy fçinjëve Makfire Igrishtës dhe Musa Goxhulit, kishte filluar një zënkë ndërmjet Safet Goxhulit në njërin anë dhe Isa Igrishtës në anën tjetër, ku të pranishëm ishin edhe Ramadan Goxhuli, Ahmet Goxhuli dhe Agron Goxhuli. Së shpejti pas kësaj kishin arritur me veturë Bashkim Igrishta dhe gruaja e tij Makfire Igrishta. Këta të fundit ishin larguar shumë shpejtë për ta kërkuar mbështetjen e policisë pasi që biseda ishte e furishme. Kur u kthyen situata kishte eskaluar. Deklaratat e qëndrueshme dhe të pandryshueshme të dëshmitarëve, të të pandehurëve dhe policëve të pranishëm në vendngjarje, i mbështesin faktet se të shtënat ishin dëgjuar kur Bashkim Igrishta ishte afruar te grumbulli i njerëzve në BMW-në e tij të kuqe pas së cilës vinte një veturë e policisë me dy policë dhe se situata kishte eskaluar kur Ahmet Goxhuli është goditur nga vetura e Bashkim Igrishtës. Gjithashtu është e pakontestueshme se posa kishin arritur policët Faik Kajtazi dhe Rafet Ibrahimimi dhe kishin kërkuar nga Agron, Ahmet dhe Safet Goxhuli t'i lëshonin armët ata e kishin bërë këtë pa ndonjë rezistencë. Bashkim Igrishta ishte lënduar nga një plumb në dorën e majtë dhe ishte arrestuar në shtëpinë e tij. Isa Igrishta ishte i shtrirë në tokë, ishte gjetur i vdekur kur kishte arritur policia. Makfire Igrishta ishte transportuar në spital por nuk kishte mbijetuar për shkak të plagëve.

1. Dëshmitë lidhur me **Bashkim Igrishtën** i akuzuar për vrasje në tentativë kundër Ahmet Goxhulit

Nuk kontestohet se më 04 Dhjetor 2009 Bashkim Igrishta ishte në Mitrovicë me gruan e tij Makfire Igrishta me veturën e tij BMW e kuqe, me targa 590-KS-858 dhe e kishte goditur Ahmet Goxhulin për muri. Ramadan Goxhuli në deklaratën e tij në shqyrtimin kryesor gjyqësor ka thënë se njerëzit kishin bërtitur dhe paralajmëruar se BMW-ja e kuqe ishte duke shkuar tepër shpejtë dhe se mund ta vriste dikend. Pas kësaj, Ramadan Goxhuli ka thënë se i kishte mbyllur sytë dhe nuk kishte parë asgjë derisa kishte ardhur policia. Safet, Agron dhe Ahmet Goxhuli e kanë konfirmuar versionin e Ramadan Goxhulit. Ata gjithashtu kanë treguar se arritja e shpejtë e Bashkim Igrishtës e kishte inicuar pjesën tjetër të incidentit pasi që ata ishin frikuar dhe kishin filluar të bërtisnin. Ata të gjithë kanë deklaruar se kur kishte arritur Bashkim Igrishta me BMW-në e tij të kuqe, ai po e ngiste ate vërtetë shpejt dhe e kishte shkelur Ahmet Goxhulin duke e shtyrë për një muri me tulla me pjesën e përparme të majtë të veturës. Kjo vërtetohet nga



fotografitë e veturës që tregojnë qartë pjesën e përparme të majtë të veturës të dëmtuar pas një përplasje me një objekt të fortë (shiko foto albumin e datës 09 Dhjetor 2009, fotografitë numër 4 dhe 15).

Ahmet Goxhuli ka thënë në deklaratën e tij dhënë para prokurorit publik më 19 Shkurt 2010 se ai ishte i vetmi që nuk ka mundur të ikte. Pasi ishte goditur nga vetura, ishte rrokullisur përnbi kapakun e motorit të veturës dhe e kishte humbur vetëdijen para se ta kapte armën e Isa Igrishtës.

Bashkim Igrishta e pranon se e ka shkelur Ahmet Goxhulin por ai sqaron se e kishte bërë këtë pasi e kishte humbur kontrollin ndaj veturës së tij.


Gjykata e refuzon argumentin e humbjes së kontrollit ndaj veturës. Provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës dhe dëshmitë e dëshmitarëve, policëve të përfëshirë , e përjashtojnë këtë mundësi. Përveç kësaj, nga vendshiqimi i bërë më 20 Tetor 2011, trupi gjykues është i mendimit se nëse Bashkim Igrishta do ta kishte humbur kontrollin ndaj veturës, ai nuk do të kishte qenë në gjendje që të arrijë ta bëjë kthesën në form të shkronjës L në fund të rrugës me baltë, atij do t'iu kishte dashur ta ndalte veturën më heret dhe jo mu para kësaj dere të shtëpisë.

Edhe pse nuk është vërtetuar se Bashkim Igrishta kishte qëllim të drejtëpërdrejtë që ta vriste Ahmet Goxhulin me veturën e tij, ai megjithatë ka qenë i vetëdijshëm për rrezikun e shkakimit të vdekjes së disa prej njerëzve gjerësa kishte shpejtuar veturën e tij në grup njerëzish siç ishte rasti. Prandaj, nga elemente të ndryshme, është vërtetuar se Bashkim Igrishta e kishte shpejtuar veturën e tij, e kishte ngarë veturën aty ku ishte Ahmet Goxhuli, kishte arritur që ta shkel atë, e kishte goditur në këmbë dhe e kishte shtyrë për muri. Si pasojë, Ahmet Goxhuli kishte rënë mbi kapakun e motorit të veturës.

Veprimi kishte mbetur i papërfunduar pasi që Bashkim Igrishtës iu dasht të largohet nga vendi i krimit pasi kishte dëgjuar të shtënat e armëve dhe kur kishte kuptuar se e kishte goditur viktimën.

Prandaj, Gjykata e shpallë Bashkim Igrishtën fajtor për veprimin kriminal të Vrasjes në Tentativë kundër Ahmet Goxhulit, në kundërshtim të Nenit 146 lidhur me Nenin 20 të KPK.

## 2. Dëshmitë lidhur me **Safet Goxhulin**




## *2.a) Për akuzën e vrasjes së rëndë të Isa Igrishtës dhe Makfire Igrishtës*

Është e pakontestueshme se me datën 04 Dhjetor 2009, Safet Goxhuli ishte prezent në shtëpinë e babait të tij me Agron Goxhulin dhe Ahmet Goxhulin. Rrugës duke dalur ata ishin takuar me Isa Igrishtën i cili ishte duke pritur jashtë. Kishte filluar një fjalosje mes tyre. Ramadan Goxhuli ka treguar gjatë shqyrtimit gjyqësor se i kishte rënë shuplak djalit të tij Safetit i cili ishte mosrespektues ndaj Isa Igrishtës. Kur Bashkim Igrishta dhe gruaja e tij kishin arritur me veturë, situata ishte përkeqësuar. Prandaj, sipas këshillave të Isa Igrishtës, ata ishin larguar për ta thirrur policinë. Kur ishin kthyer, menjëherë pas tyre përcjellur nga vetura e policisë, Bashkim Igrishta ka thënë se kishte dëgjuar të shtënat e armëve. Kjo është konfirmuar në shqyrtimin gjyqësor nga dy policët që e përcillnin BMW-në e kuqe. Përveq kësaj, ata gjithashtu kanë thënë se ata nuk kishin parë që ishte shtënë me armë nga vetura e kuqe. Pasi ishin dëgjuar të shtënat Bashkim Igrishta dhe dy policët ishin dëshmitarë që Isa Igrishta ishte rrëzuar në tokë. Kjo nuk është kontestuar asnjëherë.

Ramadan Goxhuli është i vetmi dëshmitar i cili e ka mohuar se Safet Goxhuli dhe Isa Igrishta kishin armë në duar. Deklarata e tij nuk vërtetohet nga deklarata e vetë Safet Goxhulit i cili e kishte pranuar disa herë gjatë hetimeve dhe në shqyrtimin kryesor gjyqësor se kishte armë (numri referues i pistoletës së konfiskuar në vendin e ngjarjes: tip TT e kalibrit 7.62X25mm, ngjyrë e zezë, numri serik 967473766- 1964, prova D#9) dhe se ai kishte shtënë në Isa Igrishtën. Gjerësa e kishte pranuar në intervistën e tij me Prokurorin të datës 22 Janar 2010 se kishte shtënë pesë herë në viktimën, atij nuk i kujtohej gjatë shqyrtimit gjyqësor se sa herë kishte shtënë në të. Agron Goxhuli ka konfirmuar të shtënat e Safet Goxhulit në deklaratën e tij dhënë prokurorit publik me datën 14 Prill 2010, megjithatë, ai nuk ka cekur se në cilin drejtim kishte shtënë.

Raporti i autopsisë i Isa Igrishtës, i datës 07 Dhjetor 2009 tregon se gjatë ekzaminimit me rreze X të tërë trupit të viktimës, nuk është hetuar as plumb e as ndonjë fragment metali. As raporti i balistikës i datës 9 Gusht 2010 nuk identifikon ndonjë gëzhojë e cila përputhet me ndonjë armë të të pandehurve afër trupit. Megjithatë, kjo nuk përjashton asnjë nga këto meqë raporti tregon se, për shembull, sipas provës së dërguar D#4.1 (një këmishëz dhe tri fragmente metalike) të gjetura pranë trupit të Isa Igrishtës, ato nuk kanë karakteristika balistike për ekzaminim. Përkundër mungesës së dëshmime balistike, nga raporti i autopsisë i cili vjen në përfundim se viktimja kishte vdekur nga lëndimet e shumta të të shtënave me armë, është vërtetuar qartazi se Isa Igrishta kishte tetë



vrime në trupin e tij të shkaktuara nga të shtënat me armë, katër vrime hyrëse dhe katër vrime dalëse. Këto prova materiale vërtetojnë deklaratën e Safet Goxhulit i cili tregon se kishte shtënë disa herë në viktimën.

Sa i përket posedimit të armës nga Isa Igrishta, Safet dhe Ahmet Goxhuli vazhdimisht kanë treguar se Ahmeti kishte marrë armën e Isa Igrishtës pasi që ai ishte rrëzuar në tokë. Kjo përjashton Ahmet Goxhulin të ketë shtënë në Isa Igrishtën.

Sa i përket mundësisë që Agron Goxhuli të ketë shtënë në Isa Igrishtën, kjo është dhënë në detaje më poshtë, por për shkak të mungesës së dëshmive, edhe pse ai kishte armë dhe kishte shtënë me të, nuk është vërtetuar se ai e kishte vrarë Isa Igrishtën.

Prandaj, nga deklaratat e Safet Goxhulit, me të cilën ka pranuar se kishte shtënë disa herë në viktimat, të shtëna që janë konfirmuar nga dëshmitarët tjerë dhe nga raporti i autopsisë i cili tregon se katër predha kanë shkaktuar vdekjen duke përshkuar trupin e viktimës, Gjykata është e bindur se Safet Goxhuli është fajtor për vrasjen e Isa Igrishtës.

Vetë-mbrojtja duhet të përjashtohet në këtë rast pasi që asnjë dëshmi nuk e mbështet këtë version përveç deklaratës së Safet Goxhulit, siç është zhvilluar më lartë. Përkundër faktit që kishte shtënë, Safet Goxhuli ka treguar gjatë shqyrtimit gjyqësor se nuk kishte për qëllim ta vrasë Isa Igrishtën. Është i pakontestueshëm fakti se edhe pse kishte armë, ai nuk e kishte nxjerrë atë që nga fillimi i fjalosjes por kishte pritur që tensioni të arrinte pikën kulmore kur Bashkim Igrishta ishte kthyer duke e ngarë veturën shpejtë në mënyrë të rrezikshme. Safet Goxhuli ka treguar se e kishte nxjerrë armën vetëm kur Isa Igrishta kishte filluar të shtie në BMW në drejtim të kusherinjëve të tij Ahmet dhe Agron Goxhuli.

Makfire Igrishta, 23 vjeçare, është gjetur e shtrirë në tokë jashtë veturës së burrit të saj, të parkuar para derës së shtëpisë së Igrishtëve, në anën e pasagjerit. Në shqyrtimin kryesor gjyqësor, Bashkim Igrishta ka treguar se ai nuk e kishte vrejtur që ajo ishte goditur nga plumbi gjerësa ata akoma ishin në veturë. Megjithatë, ai ka cekur se kishte dëgjuar atë tek bërtiste "*lëshomi flokët*".

Raporti i autopsisë i Makfire Igrishtës i datës 04 Dhjetor 2009 tregon se ajo kishte nëntë vrime në trupin e saj të shkaktuara nga të shtënat me armë, katër vrime hyrëse, katër vrime dalëse dhe një plumb që ishte gjetur në pjesën e majtë të



gjoksit të saj. Kjo bjen në përfundim se ajo kishte vdekur nga një shok hemorragjik nga lëndimet e të shtënave me armë.

Asnjë i pandehur nuk ka pranuar se kishte shtënë në te.

Megjithatë, nga raporti i balistikës i datës 09 Gusht 2010 (ref 2010- 0123), dy të gjetura lidhen me vdekjen e Makfire Igrishtës.

E gjetura e parë ka të bëjë me plumbin e gjetur në pjesën e majtë të gjoksit të saj. Plumbi është identifikuar të ishte shtënë nga pistoleta e Ahmet Goxhulit (shiko raportin e balistikës (ref 2010- 0123) faqe 5 *“në bazë të krahasimeve mikroskopike rezulton se një plumb nga prova D#33 (predha e marrë nga trupi i Makfire Igrishtës) ka të njëjtat karakteristika individuale balistike me plumbat e shkrepur gjatë të shtënave testuese nga pistoleta C. ZASTAVA e kalibrit 7.62X25mm nga prova F6 (pistoletë e konfiskuar nga duart e Ahmet Goxhulit në vendin e krimit), kjo nënkupton se një plumb nga prova D#33 është shkrepur nga pistoleta C. ZASTAVA e kalibrit 7.62X25mm me numër serik C-132205.”*)

E gjetura e dytë ka të bëjë me gëzhhojën e gjetur pranë trupit të saj (referenca me provën D#17). Përfundimi i raportit balistik tregon se vetëm një gëzhhojë ishte identifikuar dhe ishte përputhur me pistoletën e njërit nga të pandehurit *“na bazë të krahasimeve mikroskopike të zhvilluara rezulton se një gëzhhojë e kalibrit 7.62X25mm nga prova D#17 (fotografia e gëzhhojës së gjetur pranë trupit të viktimës) ka të njëjtat karakteristika individuale balistike me gëzhhojat e shkrepura gjatë të shtënave testuese nga pistoleta nga prova D#9 (fotografia e pistoletës së Safet Goxhulit e konfiskuar në vendin e krimit) që nënkupton se vetëm një gëzhhojë nga prova D#17 ishte shkrepur nga pistoleta Tip 54 e kalibrit 7.62X25mm me numër serik 9674737 66.”*

Nga e gjetura e dytë, duke patur parasysh lokacionin e gëzhhojës dhe të trupit të viktimës, të dyjat njëra pranë tjetrës, vërtetohet se Safet Goxhuli kishte shtënë në Makfire Igrishtën së paku një herë. Gjithashu, duke patur parasysh natyrën dhe vendin e lëndimeve të pësuar nga viktimë, duket se ajo përputhet me pozitën ku ishte arrestuar Safet Goxhuli.

Prandaj, Gjykata e shpallë Safet Goxhulin fajtor për vrasjen e Makfire Igrishtës.

Sa i përket kualifikimit të veprave penale, Safet Goxhuli fillimisht ishte akuzuar me vrasje të rëndë nga Neni 147 pika 4 dhe 11 e KPK *“ka privuar personin tjetër nga jeta dhe duke vepruar kështu ka rrezikuar jetën e një apo më shumë personave”*. Megjithatë, nga debati gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nga provat



materiale në shkresat e lëndës, Gjykata merr në konsiderim vetëm akuzat nga Neni 147 Para (11) i KPK duke marrë në konsiderim këto dy vrasje “me qëllim kryen dy apo më shumë vrasje (...)” meqë Safet Goxhuli, duke shtënë me armën e tij në drejtim të viktimave, qëllimisht ka dashur t'i privojë ata nga jeta.

#### *1.b) Lidhur me akuzën e Vrasjes së Rëndë në Tentativë të Bashkim Igrishtës*

Për shkak të mungesës së dëshmive të mbledhura në shkresat e lëndës apo nxjerrura gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues konstatoi se i akuzuari Safet Goxhuli nuk ishte fajtor për veprimin kriminal të vrasjes në tentativë kundër Bashkim Igrishtës, në kundërshtim të Nenit 147 Paragrafi (1) pika 4 dhe 11 lidhur me Nenin 20 të KPK.

Prandaj, trupi gjykues e liron Safet Goxhulin nga akuza e vrasjes së rëndë në tentativë të Bashkim Igrishtës.

#### *2.c) Lidhur me akuzën e Mbjajtjes në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve*


Gjykata e pranon deklaratën mbi pranimin e fajsisë së të akuzuarit gjatë hetimeve, të cilën e kishte përsëritur edhe gjatë shqyrtimit kryesor dhe e shpall Safet Goxhulin fajtor për mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armës, përkatësisht pistoletës të tipit TT, ngjyrë e zezë, me numër serik. 967473766-1964 e kalibrit 7.62X25mm e konfiskuar në vendin e krimit me 04 Dhjetor 2009 në Mitrovicë në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi (2) i KPK.

### 3. Dëshmitë lidhur me Agron Goxhulin

#### *3.a) Lidhur me akuzën e Vrasjes së Rëndë të Isa Igrishtës dhe Makfire Igrishtës*

Është fakt i pakontestueshëm, edhe pse Agron Goxhuli është mbrojtur në heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor se ai paraprakisht kishte pranuar në deklaratën e tij dhënë policisë me datën 04 Dhjetor 2009 dhe e kishte konfirmuar te Prokurori Publik më 14 Prill 2010 se me 04 Dhjetor 2009, në Mitrovicë, posa ishte shkrepur e shtëna e parë, ai kishte nxjerr armën e tij dhe kishte shtënë në ajër katër apo pesë herë.

Bashkim Igrishta në shqyrtimin kryesor ka treguar se ai e kishte parë Agron Goxhulin duke shtënë në babain e tij tri herë, gjersa ai ishte i shtrirë në tokë.



Raporti i balistikës i datës 09 Gusht 2010 (ref 2010- 0123) konfirmon deklaratën e Agron Goxhulit pasi që tregon që gëzhoja e shkrepur nga pistoleta e Agron Goxhulit është ajo që ishte identifikuar nga prova D#20 (shiko forografinë e vendngjarjes, foto albumi i datës 04 Dhjetor 2009). Nga Foto albumi i datës 04 Dhjetor 2009, duket se gëzhoja e armës së Agron Goxhulit është gjetur mjaftë larg nga vendi ku ishte trupi i Isa Igrishtaës. Asnjë gëzhojë apo plumb tjetër nga arma e Agron Goxhulit nuk ishte gjetur afër trupit të viktimës. Prandaj, nuk ka dëshmi që mbështet pretendimin e vrasjes.

Gjykata është e mendimit se deklarata e Bashkim Igrishtës kundër Agron Goxhulit dhe gëzhoja e vetme nga arma e Agron Goxhulit e gjetur në tokë nuk janë të mjaftueshme për ta karakterizuar vrasjen.

Prandaj, Gjykata e shpallë Agron Goxhulin të pafajshëm për vrasjen e Isa Igrishtës.

Sa i përket akuzës për vrasjen e Makfire Igrishtaës, nuk ka dëshmi (nuk ka as gëzhoja, as plumba, as dëshmi) që mbështesin pretendimin se Agron Goxhuli ka mundësi të ketë shtënë në të.


Prandaj, për shkak të mungesës së dëshmive, Gjykata e shpallë Agron Goxhulin të pafajshëm për akuzat e vrasjes së rëndë në kundërshtim të Nenit 147 Paragrafi (1) Pika 4 dhe 11 lidhur me Nenin 20 të KPK dhe e liron atë nga kjo akuzë

### *3.b) Sa i përket akuzës për Vrasje të Rëndë në Tentativë të Bashkim Igrishtës*

Për shkak të mungesës së dëshmive të mbledhura në shkresat e lëndës apo të nxjerrura gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues konstatoi se i akuzuari Agron Goxhuli nuk ishte fajtor për veprimin kriminal të vrasjes në tentativë ndaj Bashkim Igrishtës, në kundërshtim të Nenit 147 Paragrafi (1) pika 4 dhe 11 lidhur me Nenin 20 të KPK.

Prandaj, trupi gjykues e liron Agron Goxhulin nga akuza e vrasjes së rëndë në tentativë të Bashkim Igrishtës.

### *3.c) Sa i përket akuzës për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve*



Gjykata e pranon deklaratën mbi pranimin e fajsisë të Agron Goxhulit i cili gjatë hetimeve (intervista dhënë policisë e datës 04 Dhjetor 2009, intervista dhënë prokurorit publik e datës 14 Prill 2010) dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë eksplicite ka pranuar se është pronar dhe mbanë me vete armën e tij që nga lufta. Deklarata e tij është konfirmuar nga Safet Goxhuli i cili i tregon prokurorit publik me 22 Janar 2010 se "Agroni gjithmonë bartë me vete armën e tij që nga paslufta".

Prandaj, Gjykata e shpallë Agron Goxhulin fajtor për Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armës, përkatësisht të pistoletës C.ZASTAVA të kalibrit 7.62X25mm me numër serik C-160982 të konfiskuar në vendin e krimit më 04 Dhjetor 2009 në Mitrovicë në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi (2) i KPK.


#### 4. Dëshmitë lidhur me Ahmet Goxhulin

##### 4.a) Lidhur me akuzën e Vrasjes së Rëndë të Isa Igrishtës dhe *Makfire Igrishtës*

Është e pakontestueshme se Ahmet Goxhuli kur ishte arrestuar më 04 Dhjetor 2009 në Mitrovicë kishte një armë (referencë pistoleta e konfiskuar: M57-TT e kalibrit 7.62X25mm, me numër serik C-132205). Dy policët që kishin arritur në vendin e krimit kishin kërkuar nga ai që të ndalej dhe ai u dorëzua pa rezistuar. Ahmet Goxhuli sqaron posedimin e kësaj arme duke thënë se e kishte marrë nga toka kur ishte rrëzuar Isa Igrishta, i goditur nga plumbat. Deklaratat e tij janë të pandryshueshme që nga intervista e tij dhënë Prokurorit Publik më 19 Shkurt 2010. Deklaratat e Safet Goxhulit e vërtetojnë këtë gjatë hetimeve dhe në shqyrtimin kryesor gjyqësor duke thënë, " arma të cilën e kishte Isa në dorë ka rënë afër Ahmetit kur është rrëzuar Isa (...) *gabimi më i madh ishte që Ahmeti e kishte marrë këtë armë*".

Nga provat e ndryshme në shkresat e lëndës, nuk është e kontestueshme të arrihet në përfundimin se Ahmet Goxhuli e ka marrë armën të cilën e kishte në posedim nga Isa Igrishta pasi që ky i fundit ishte rrëzuar në tokë, i goditur nga plumbat e shtënë nga Safet Goxhuli, siç vërtetohet me detajet e mësipërme, andaj nuk ka mundësi që ai ta kryej vrasjen e Isa Igrishtës. Përveç kësaj, asnjë provë material nuk e mbështet këtë mundësi.

Vetëm posedimi i armës nga Ahmet Goxhuli nuk mjafton për ta mbështetur akuzën kundër Ahmet Goxhulit për vrasjen e Isa Igrishtës. Prandaj, gjykata e shpall Ahmet Goxhulin të pafajshëm për vrasjen e Isa Igrishtës.



Sa i përket vdekjes së Makfire Igrishtës, gjykata është e bindur se Ahmet Goxhuli kishte shtënë nga distanca me një revole C ZASTAVA M-57 e kalibrit 7.62X25mm, me numër serik C-132205 pasi që një nga plumbat e tij është gjetur në pjesën e majtë të gjoksit të saj (shiko raportin e autopsisë 07 Dhjetor 2009 MA 09 329) që kishte kontribuar në vdekjen e saj.

Si provë materiale, raporti i balistikës i datës 09 Gusht 2010 (ref 2010- 0123) tregon se një predhë që ishte marrë nga trupi i viktimës Makfire Igrishta (D#33) ka të njëjtat karakteristika individuale me plumbat e shkrepur gjatë të shtënave testuese nga pistoleta e kalibrit 7.62X25mm që është identifikuar se ishte pistoleta e Ahmet Goxhulit. Kjo do të thotë se një plumb nga prova D#33 ishte shkrepur nga pistoleta me numër serik C- 132205.

Është thënë se që të dytë Isa Igrishta dhe Ahmet Goxhuli përkohësisht e kanë pasur në posedim pistoletën me numër serik C- 132205. Megjithatë, duhet përjashtuar se Isa Igrishta kishte shtënë në Makfire Igrishtën pasi që ai ishte në anën e djathtë të veturës dhe nuk ishte e mundur që ai të ketë shtënë dhe qëlluar Makfiren nga ajo pozitë pasi që nuk ishin gjetur gjurmë, plumba, vrime etj ... në atë anë të veturës, dhe as nuk ka pasur gjak brenda në veturë. Përveç kësaj, i ndjeri ishte i shtrirë në tokë, i goditur nga plumbat kur Bashkim Igrishta kishte parkuar veturën para shtëpisë së tij dhe kur gruaja e tij kishte dalur nga vetura. Ishte ky momenti kur ishte shtënë në të.

Nga deklaratat e ndryshme në shkresat e lëndës, përsëritur në shqyrtimin gjyqësor, është e qartë se Ahmet Goxhuli ishte dezorientuar pasi ishte shkelur nga vetura e Bashkim Igrishtës. Edhe pse Ahmet Goxhuli është mbrojtur në heshtje gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor, ai megjithatë i kishte thënë prokurorit publik më 19 Shkurt 2010 se *"kur më ka goditur BMW-ja dhe jam lënduar, unë jam rrëzuar dhe jam shtrirë përmbys në tokë dhe e kam humbur vetëdijen (...)* kur më është kthyer vetëdija, kam provuar të ngritem , por nuk kam mundur dhe jam rrëzuar prap. Në këtë moment, e kam parë armën, që ishte pistoletë, dhe e kam futur në brez (...)". Ahmet Goxhuli gjithmonë e ka mohur se kishte përdorur armën. Deklaratat e Safet Goxhulit dhe Agron Goxhulit e mbështesin këtë deklaratë. Megjithatë, versionet e tyre kundërshtohen nga deklaratat e Bashkim Igrishtës i cili gjatë tërë hetimit si dhe gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor, vazhdimisht ka thënë se Ahmet Goxhuli kishte shtënë në të kur ky ishte në veturë dhe më vonë. Ai ka cekur se kur kishte arritur të hyjë në oborr, pasi kishte parkuar veturën, ka dëgjuar njerëzit që bërtitnin *"Jo gruan"* dhe pastaj kishte dëgjuar një të shtënë arme (shiko intervistën dhënë në polici më 04 Dhjetor 2009



dhe intervistën dhënë prokurorit publik më 14 Prill 2010). Plumbi i gjetur në trupin e Makfire Igrishtës e vërteton versionin e Bashkim Igrishtës.

Pa dyshim, Ahmet Goxhuli, menjëherë pasi ishte shkelur nga vetura e Bashkim Igrishtës, e kishte marrë armën që kishte qenë në tokë dhe e kishte përdorur atë edhe pse ishte plotësisht nën një gjendje të shqetësimit të madhë mendor dhe i dezorientuar nga shoku që kishte pësuar. Nuk është vërtetuar se ai kishte shtënë me qëllim në Makfire Igrishtën megjithatë, është e sigurt se një plumb i tij kishte kontribuar në vrasjen e saj.

Prandaj, Gjykata shpall Ahmet Goxhulin fajtor për vrasjen e Makfire Igrishtës. Fajtor vetëm për një vrasje, Gjykata i modifikon akuzat fillestare kundër Ahmet Goxhulit nga Vrasje e Rëndë në Vrasje në shkelje të Nenit 146 të KPK.


#### *4.b) Lidhur me akuzën e Vrasjes së Rëndë në Tentativë të Bashkim Igrishtës*

Për shkak të mungesës së dëshmive të mbledhura në shkresat e lëndës apo të nxjerrura gjatë shqyrtimit gjyqësor, trypi gjykues konstatoi se i akuzuari Ahmet Goxhuli nuk ishte fajtor për veprimin kriminal të Vrasjes në Tentativë ndaj Bashkim Igrishtës, në kundërshtim të Nenit 147 Paragrafi (1) pika 4 dhe 11 lidhur me Nenin 20 të KPK.

Prandaj, trupi gjykues e liron Ahmet Goxhulin nga akuza e vrasjes së rëndë në tentativë të Bashkim Igrishtës në kundërshtim të Nenit 147 Paragrafi (1) pika 4 dhe 11 lidhur me Nenin 20 të KPK.

#### *4. c) Lidhur me akuzën Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve.*

Duke qenë se është shpallur fajtor për vrasjen e Makfire Igrishta të kryer me një revole e tipit C ZASTAVA M-57 e kalibrit 7.62X25mm, me numër serik C-132205, Gjykata e shpall Ahmet Goxhulin fajtor për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi (2) i KPK.



## **G. Caktimi i Dënimit**

Gjatë shqiptimit të sanksionit penal, Gjykata ka parasyshtë qëllimin e përgjithshëm të dënimit- që t'i ndalojë aktivitetet e rrezikshme shoqërore duke i parandaluar të tjerët nga kryerja e veprimeve të ngjajshme kriminale- dhe qëllimin specifik- që ta parandalojë kryerësin nga kryerja e ndonjë vepre të re penale.

Për caktimin e kohëzgjatjes së dënimit, Gjykata duhet t'i vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, sipas Nenit 64 Paragrafi (1) i KPK duke mbetur brenda kufijëve të dënimit të parapar me ligj.

### **Bashkim Igrishta**

Gjykata mori në konsiderim si rrethanë rënduese faktin se Bashkim Igrishta kishte rrezikuar shëndetin e në shumë se një personi duke e ngarë veturën me shpejtësi në një rrugë të ngushtë ku po qëndronin një grup njerëzish dhe faktin se ai më parë ka qenë i dënuar. Gjykata ishte e mendimit se nuk ka ndonjë rrethanë lehtësuese.

Për veprimin kriminal të Vrasjes së Rëndë në shkelje të Nenit 146 lidhur me Nenin 20 të KPK, ligji parasheh dënimin prej së pakut pesë vjet burgim. Gjykata i shqipton dënimin prej 7 vjet burgim Bashkim Igrishtës për këtë vepër penale.

Bashkim Igrishta ka qenë në paraburgim që nga data 04 Dhjetor 2009. Paraburgimi do të llogaritet në dënim sipas Nenit 73 Paragrafi (1) të KPK.

### **Safet Goxhuli**

#### *Për Vrasjen e Rëndë*

Si rrethanë rënduese Gjykata mori në konsiderim faktin se Safet Goxhuli kishte shtënë në viktimat e dobëta dhe të pambrojtura.

Si rrethanë lehtësuese Gjykata mori në konsiderim faktin se pas konfliktit fillestar para dyerëve Goxhulët dhe Isa Igrishta ia arritën ta menaxhojnë situatën në mënyrë të qetë. Gjithashtu është vërejtur mirë se megjithëse Safet Goxhuli kishte përjetuar një shqetësim të nivelit të lartë, ai nuk e kishte përdorur armën që nga fillimi i mosmarrëveshjes. Vetëm pasi që ishte provokuar gjatë disa ditëve të fundit dhe përfundimisht me ardhjen me shpejtësi të madhe të Bashkim Igrishtës,



si reagim të atij që po kryente veprën penale dhe duke qenë dëshmitar i rrezikut jetësor të familjes së tij, ai kishte reaguar dhunshëm. Safet Goxhuli nuk ka pasur dënime paraprake.

Për veprimin kriminal të Vrasjes së Rëndë në shkelje të Nenit 147 Paragrafi (1) pika 11 e KPK, ligji parasheh dënimin prej së paku dhjetë vjet burgim apo burgim afatgjatë. Gjkata i shqipton Safet Goxhulit dënimin prej katërmbëdhjetë (14) vjet burgim për këtë vepër penale.

*Për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve*

Si rrethanë rënduese Gjykata mori në konsiderim faktin se Safet Goxhuli e kishte armën në posedim për shumë vite.

Si rrethanë lehtësuese Gjykata mori në konsiderim faktin se Safet Goxhuli nuk e kishte përdorur armën që nga fillimi i mosmarrëveshjes përkundër faktit se ishte sulmuar. Ai e kishte përdorur atë vetëm kur ishte provokuar seriozisht.

Për veprimin kriminal të Mbajtjes në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve në shkelje të Nenit 328 Paragrafi (2) i KPK, ligji parasheh dënimin me gjobë deri në 10.000 Euro apo dënimin me burg prej një deri në dhjetë vjet. Gjykata i shqipton Safet Goxhulit dënimin prej një (1) viti burgim për këtë vepër penale.

I Akuzuari Safet Goxhuli ka kryer dy veprime kriminale. Sipas rregullave të kalkulimit të dënimit të përbër, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se secili dënim individual, por jo aq i lartë sa shuma e dënimeve të përshkruara. Trupi gjykues shqiptoi dënimin unik prej 14 vjet e 6 muaj burgim sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe (2) pika ii) e KPK.

Safet Goxhuli ka qenë në paraburgim që nga data 04 Dhjetor 2009. Paraburgimi do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

### **Agron Goxhuli**

Si rrethanë rënduese Gjykata mori në konsiderim faktin se Agron Goxhuli ishte në posedim të armës për një kohë të gjatë, që nga fundi i luftës dhe e kishte përdorur atë.



Si rrethanë lehtësuese Gjykata e mori në konsiderim faktin se Agron Goxhuli nuk ka pasur dënime paraprake.

Për veprimin kriminal të Mbajtjes në pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve në shkelje të Nenit 328 Paragrafi (2) e KPK, ligji parasheh dënimin me gjobë deri në 10.000 Euro apo me burgim prej një deri në dhjetë vjetë. Gjykata i shqipton Agron Goxhulit dënimin prej një (1) vit burgim për këtë vepër penale.

Agron Goxhuli ka qenë në paraburgim që nga data 04 Dhjetor 2009 deri më 08 Nëntor 2011, kur është liruar nga kjo Gjykatë. Paraburgimi do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

### **Ahmet Goxhuli**

#### *Për Vrasje*


Gjykata është e mendimit se nuk ka pasur rrethana rënduese në këtë rast gjerësa si rrethanë lehtësuese Gjykata mori në konsiderim kryerjen e veprës nënë shqetësimin e madhë mendor, përkatësisht pasi ishte shkelur nga një veturë. Ahmet Goxhuli nuk ka pasur dënime paraprake.

Për veprimin kriminal të Vrasjes në shkelje të Nenit 146 të KPK, ligji parasheh dënimin prej së pakut pesë vjet burgim. Por gjykata i shqipton Ahmet Goxhulit dënimin prej katër vjet për këtë vepër penale për shkak të kushteve në të cilat është kryer vepra penale, përkatësisht nivelit të lartë të dezorientimit të të pandehurit në kohën e kryerjes së krimit..

#### *Për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armës*

Si rrethanë rënduese Gjykata mori në konsiderim faktin se Ahmet Goxhuli e kishte kapur dhe përdorur armën. Si rrethanë lehtësuese Gjykata mori në konsiderim faktin se ai ishte në gjendje të shqetësimit mendor. Nuk është vërtetuar se ai ka poseduar armë para datës 04 Dhjetor 2009. Ahmet Goxhuli nuk ka pasur dënime paraprake.

Për veprimin kriminal të Mbajtjes në pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve në shkelje të Nenit 328 Paragrafi (2) e KPK, ligji



parasheh dënimin me gjobë deri në 10.000 Euro apo me burgim prej një deri në dhjetë vjetë. Gjykata i shqipton Ahmet Goxhulit dënimin me gjobë prej 1.000 Euro për këtë veprë penale.

Ahmet Goxhuli ka qenë në paraburgim që nga data 04 Dhjetor 2009 deri më 08 Nëntor 2011 dhe nën masën e arrestit shtëpiak nga momenti i shpalljes së aktgjyimit më 08 Nëntor 2011. Paraburgimi dhe arresti shtëpiak do t'i llogariten në dënimin e shqiptuar sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

#### **H. Konfiskimi**

Sipas Nenit 328 Paragrafi (5) i KPK, gjykata urdhëron konfiskimin si në vijim:

Arma e cila është përdorur për ta kryer veprën penale (Safet Goxhuli) – pistoletë e tipit TT, ngjyrë e zezë me numër serik 967473766-1964 në të cilën kishte fyshekë konfiskohet sipas Nenit 60 Paragrafi (1) dhe Nenit 328 Paragrafi (5) i KPK.

Arma e cila është përdorur për ta kryer veprën penale (Agron Goxhuli) – pistoletë e tipit TT, ngjyrë e zezë me numër serik 160982, në të cilën kishte fyshekë konfiskohet sipas Nenit 60 Paragrafi (1) dhe Nenit 328 Paragrafi (5) i KPK.

Arma e cila është përdorur për ta kryer veprën penale (Ahmet Goxhuli) - pistoletë e tipit M57 me numër serik 132205, konfiskohet sipas Nenit 60 Paragrafi (1) dhe Nenit 328 Paragrafi (5) i KPK..

Vetura që ishte përdorur për ta kryer veprën penale – BMW me targa 590-KS-858 konfiskohet sipas Nenit 328 Paragrafi (5) i KPK.

#### **I. Shpenzimet**

Safet Goxhuli, Agron Goxhuli, Ahmet Goxhuli dhe Bashkim Igrishta janë shpallur fajtor, prandaj ata duhet t'i kompenzojnë shpenzimet e procedurës penale si në vijim:

- Safet Goxhuli do t'i kompenzojë 300 Euro për pjesën e tij të shpenzimeve të procedurës penale,
- Agron Goxhuli do t'i kompenzojë 100 Euro për pjesën e tij të shpenzimeve të procedurës penale,



- Ahmet Goxhuli do t'i kompenzojë 300 Euro për pjesën e tij të shpenzimeve të procedurës penale,
- Bashkim Igrishta do t'i kompenzojë 300 Euro për pjesën e tij të shpenzimeve të procedurës penale,

sipas Nenit 102 Paragrafi (1) i KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit gojor dhe me shkrim.

Meqë Xhemë Igrishta është shpallur i pafajshëm, ai lirohet nga detyrimi i kompenzimit të shpenzimeve të procedurës penale.

### Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

P. nr. 22/10

Përgaditur në gj. angleze , gjuhë e autorizuar.


Kryetrajja e Trupit Gjykoes  
Caroline Charpentier

Anëtari i Trupit Gjykoes  
Nikolay Entchev

Anëtari i Trupit Gjykoes  
Ali Kutllovci



Procesmbajtëse  
Anu Juho



#### Këshillë Juridike:

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh nga data kur është pranuar një kopje e këtij aktgjykimi.